



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Zl.Anr.173/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi kryesues, Afijete Sada-Gllogjani dhe Ymer Hoxha anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares së lartë ligjore Florije Krasniqi, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Partia Demokratike e Ashkalinjëve të Kosovës (PDAK), me dega në Fushë Kosovë, paraqitur kundër subjektit politik Partia Liberale Egjiptiane (PLE), dega në Fushë Kosovë, për shkak të vendosjes së materialit zgjedhor në shtylla elektrike për Zgjedhjet Lokale 2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 12.10.2017, mori këtë:

## V E N D I M

**Pranohet** si e bazuar ankesa e subjektit politik Partia Demokratike e Ashkalinjëve të Kosovës (PDAK), dega në Fushë Kosovë, ndërkaq subjektit politik Partia Liberale Egjiptiane (PLE), dega në Fushë Kosovë, i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 300 (treqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimi të këtij vendimi nën kërcënim të përmbaramit.

## A r s y e t i m

Me datën 10.10.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga subjekti politik Partia Demokratike e Ashkalinjëve të Kosovës (PDAK), dega në Fushë Kosovë, me të cilën pretendon se në lagjen 28, rrugën “Meshari” dhe në rrugën “Isuf Hoxha”, në Fushë Kosovë anëtarët për kuvend të Komunës së Fushë Kosovës nga radhët e subjektit politik Partia Liberale Egjiptiane (PLE), dega në Fushë Kosovë, kanë vendosur postera në shtyllë elektrike.

Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se është bërë shkelje e rregullave zgjedhore në momentin që ka vendosur posterat në rrugë publike.

Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur 5 fotografi lidhur me rastin në fjalë.

Në përgjigjen në ankesë nga subjekti politik PLE, të datës 12.10.2017, e kanë pranuar shkeljen e pretenduar në ankesë duke arsyetuar se të njëjtit kanë njoftuar kandidatët me rregullat e fushatës zgjedhore dhe se ata do të merren me seriozitet lidhur me çështjen dhe akterët e aktit.

Përgjigjes në ankesë si dëshmi për evitimin shkeljes i kanë bashkëngjitur 6 fotografi.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 2 të LZP-së, gjeti se:

## **Ankesa është e bazuar**

Nga fotografitë e ofruara si provë të cilat gjenden në shkresat e lëndës shihet qartë se posterat e kandidatëve për anëtarë të kuvendit të Komunës së Fushë Kosovës, nga radhët e subjektit politik PLE janë vendosur shtylla elektrike-rrugë publike, veprim ky që është në kundërshtim me nenin 33, pika b), të LZP-së e cila përcakton: “ *Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në apo mbi rrugët publike*”.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, me rastin e shqiptimit të gjobës mori parasysh të gjitha rrethanat për rastin konkret duke pasur parasysh faktin se subjekti politik PLE, nuk merr pjesë për herë të parë në zgjedhje dhe se e njëjtit janë të njoftuar me rregullat zgjedhore. Po ashtu si rrethanë, PZAP-i e mori edhe faktin që këtij subjekti, ia dha mundësinë për tu përgjigjur ashtu që në përgjigje e kanë pranuar shkeljen e supozuar, pretendimet në ankesë nga ana e panelit janë vlerësuar si pa ndikim në marrjen e vendimit më të favorshëm për subjektin në fjalë. Ndërsa, veprime që kanë ndërmarrë veprime për të bërë përmirësimin e shkeljes nga Paneli janë vlerësuar pozitivisht dhe me ndikim në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi. Paneli po ashtu vlerësoi dënimi i shqiptuar ndaj subjektit në fjalë do të ndikon që mos të përsëriten veprimet e kësaj natyre në të ardhmen.

Paneli në kuptim të nenit 120.1, pika c), dhe nenit 118.1, të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

ZL.Anr.173 /2017 më datën 12.10.2017.

**Kryesuesi i Panelit**  
Fejzullah Rexhepi



**Këshilla Juridike:** Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së.